



Dyzet hadithe
mbi
SALAVATIN

Tiranë, 2015



Titulli: Dyzet hadithe mbi salavatin

Përktheu dhe përshtati: Sabrie Feza

Recensent: Vullnet Merja

Redaktoi: Liseda Ramaj

Përkujdesja kompjuterike & Kopertina:

Sabrie Feza

Botoi: Fondacioni i Kur'anit - Tiranë

Parathënie

“Është e vërtetë se Allahu dhe melekët e Tij e përshëndesin me madhërim Profetin. O ju që keni besuar, nderojeni pra atë (duke rënë në salavatë) dhe përshëndeteni me selam!” (“Ahzab”, 56)

Ky ajet flet për dashurinë e Allahut dhe të melekëve të Tij ndaj Profetit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe

familjen e tij!). Pas kësaj ajeti i urdhëron besimtarët për ta nderuar atë.

Allahu thotë në Kur'an: **“Është e vërtetë se Allahu dhe melekët e Tij e përshëndesin me madhërim Profetin.”**

Krijuesi i botës së ekzistencës dhe të gjithë melekët e ngarkuar me drejtimin e çështjeve të kësaj bote me urdhrin e Allahut të Madhëruar e përshëndesin atë. Atëherë bashkoni zërat tuaj në këtë thirrje të botës së ekzistencës: **“O ju që keni besuar, nderojeni pra atë (duke rënë në salavatë) dhe përshëndeteni me selam!”**

Profeti është një xhevahir i paçmueshëm për botën e krijesave. Ai është vënë në mesin tuaj me mirësinë e Allahut. Pra,

mos e harroni pozitën dhe gradën e tij tek Allahu! Ai është një njeri që doli në mesin tonë, por ai nuk është një njeri i zakonshëm.

Pas zbritjes së ajetit të mësipërm, një prej shokëve të Profetit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!) erdhi dhe tha: *“Sa i përket përshëndetjes tënde, ne e dimë atë, por si është salavati për ty?”* Profeti tha: *“Thuaj: ‘O Allah, dërgo paqe dhe bekim mbi Muhamedin dhe familjen e Muhamedit, ashtu siç dërgove paqe dhe bekim mbi Ibrahimin dhe familjen e Ibrahimit! Me të vërtetë, Ti je shumë i falënderuar dhe i lavdëruar.’”*

Salavati mbi Profetin (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!) është aq i rëndësishëm, saqë quhet si një prej kushteve të pranimit të namazit.

Profeti Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!) ka thënë: *"Në botë është gjithmonë një karvan me melekë, të cilët janë në lëvizje. Kur ata (melekët) mbërrijnë në ndonjë ceremoni apo takim, kur përmendet Allahu dhe kur dërgohet salavat për të Dërguarin e Tij, ata i thonë njëri - tjetrit: 'Ndaloni!' E kur ndalojnë në atë vend, sa herë që të pranishmit bëjnë ndonjë lutje, ata thonë: 'Amin!' dhe sa herë që dërgojnë salavat, edhe ata dërgojnë me ta. Kur përfundon ky takim, melekët thonë: 'Lum si ata që ishin të*

pranishëm në këtë takim, sepse Allahu i ka falur ata!'"

Në një hadith tjetër, Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë:

"Kushdo që bën lutje dhe nuk e përmend emrin e Profetit Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!), ajo lutje i qëndron mbi kokë (si një perde) dhe nuk ngjitet lart. E, kur e përmend emrin e Profetit, atëherë lutja ngjitet lart."

Të nderuar lexues!

- Salavati është shenjë e dashurisë ndaj të dashurit të Allahut.

-Salavati është shkak i afrimit për tek Allahu dhe i Dërguari i Tij.

- Salavati është shkak ndërmjetësimi.
Me dërgimin e salavatit plotësohen
nevojat (dëshirat).

- Salavati është shkak i faljes së gjynaheve.

- Salavati është shkak i shëndetit dhe i -
shërimit të sëmundjeve.

- Salavati është shkak i forcimit të kujtesës.

- Salavati është shkak i fuqisë.

- Salavati është shkak i ndriçimit të varrit dhe i Kiametit.

- Salavati është shkak i pranisë së Profetit në kohën e vdekjes (dhënies shpirt).

"Allahumme sal-li ala Muhamed ue ali Muhamed"

Sabrie Feza

Hadithi 1

Njeriu më i padrejtë

قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ:

أَجَفِّي النَّاسُ رَجُلًا ذُكِرْتُ بَيْنَ يَدَيْهِ فَلَمْ يُصَلِّ عَلَيَّ.

Profeti Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!*) ka thënë: "Njeriu më i padrejtë është ai i cili dëgjon emrin tim dhe nuk dërgon salavat."

Hadithi 2

Përse Ibrahim (Paqja qoftë mbi të!) u bë mik i Allahut?

قَالَ مُولانا عَلِيُّ بْنُ مُحَمَّدٍ الهادي عليه السلام:

إِنَّمَا اتَّخَذَ اللَّهُ إِبْرَاهِيمَ خَلِيلًا لِكَثْرَةِ صَلَاتِهِ عَلَيَّ مُحَمَّدٍ وَأَهْلِ بَيْتِهِ
صَلَوَاتُ اللَّهِ عَلَيْهِمْ.

Imam Hadi (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë:
"Vërtet, Allahu e zgjodhi Ibrahimin (Paqja qoftë mbi të!) mik të Tij, për shkak se ai dërgonte shumë salavat mbi Profetin Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!) dhe mbi familjen e tij."

Hadithi 3

Koprraci i vërtetë

عَنِ الْحُسَيْنِ بْنِ عَلِيٍّ عَلَيْهِ السَّلَامُ عَنْ جَدِّهِ رَسُولِ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ:
الْبَحِيلُ حَقًّا مَنْ ذَكَرْتُ عَنْدهُ فَلَمْ يُصَلِّ عَلَيَّ.

Imam Hysejri (Paqja qoftë mbi të!) transmeton nga gjyshi i tij, profeti Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!): "Koprrac i vërtetë është ai që e dëgjon emrin tim dhe nuk dërgon salavat."

Hadithi 4

Salavati më zë të lartë

قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ:

إِرْفَعُوا أَصَوَاتَكُمْ بِالصَّلَاةِ عَلَيَّ؛ فَإِنَّهَا تَذْهَبُ بِالنَّفَاقِ.

Profeti Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!*) ka thënë: "Ngrijeni zërit tuaj kur dërgoni salavat mbi mua, sepse dërgimi i salavatit me zë të lartë largon mosmarrëveshjet dhe dyfytërsinë!"

Hadithi 5

Mirësia e të shkruarit të salavatit

قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ:

مَنْ صَلَّى عَلَيَّ فِي كِتَابٍ، لَمْ تَزَلِ الْمَلَائِكَةُ تَسْتَغْفِرُ لَهُ مَا دَامَ اسْمِي فِي ذَلِكَ
الْكِتَابِ.

Profeti Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!*) ka thënë: "*Ai që kur shkruan emrin tim, shkruan edhe salavatit, ka mirësinë që melekët të kërkojnë falje për të, derisa emri im të jetë i shkruar në atë shkrim.*"

Hadithi 6

Vepra më e rëndë në peshoren e veprave

قال أبو عبد الله أو أبو جعفر عليهما السلام:

أثقل ما يوضع في الميزان يوم القيامة، الصلاة على مُحَمَّدٍ وَ أَهْلِ

بَيْتِهِ.

Imam Bakiri (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë:
"Vepra që do të peshojë më rëndë në Ditën e Kiametit është dërgimi i salavatit mbi Profetin Muhamed dhe mbi familjen e tij (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi ta!)."

Hadithi 7

Fillojeni lutjen (duanë) me salavat

قال الصادق عليه السلام:

إذا دعا أحدكم فليبدأ بالصلاة على النبي صلى الله عليه وآله؛ فإن الصلاة على النبي صلى الله عليه وآله مقبولة ولم يكن الله ليقبل بعض الدعاء ويرد بعضاً.

Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë:
"Nëse lutet ndonjëri prej jush, le ta fillojë lutjen me dërgimin e salavatit, sepse salavati mbi profetin Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!) dhe mbi familjen e tij, është lutje e pranuar. Allahu nuk e lë një pjesë të lutjes të pranuar dhe pjesën tjetër të papranuar."

Hadithi 8

Mbrojtja nga zjarri si Xhehenemit

قَالَ مُولَانَا الصَّادِقُ عَلَيْهِ السَّلَامُ لَصَبَاحِ بْنِ سَيَّابَةَ:

أَلَا أَعْلَمُكَ شَيْئًا يَقِي اللَّهَ بِهِ وَجْهَكَ مِنْ حَرِّ جَهَنَّمَ؟ قَالَ، قُلْتُ: بَلِي، قَالَ:
قُلْ بَعْدَ الْفَجْرِ: "اللَّهُمَّ صَلِّ عَلَى مُحَمَّدٍ وَآلِ مُحَمَّدٍ" مِائَةً مَرَّةً يَقِي اللَّهَ بِهِ
وَجْهَكَ مِنْ حَرِّ جَهَنَّمَ.

Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) i ka thënë Sebah bin Sejjabe: *"A ke dëshirë që të mësoj një lutje, e cila do të jetë shkak i mbrojtjes së fytyrës tënde nga nxehtësia e Xhehenemit? I thashë: - 'Po.' Ai tha: 'Para agimit thuaj 100 herë: Allahumme sal-li ala Muhamed ue ali Muhamed.' Allahu, për mirësitë e këtij dhikri, do të të mbrojë ty nga zjarri i Xhehenemit."*

Hadithi 9

Mirësitë e dërgimit të salavatit me nijet të pastër

قال الصادق عليه السلام:

مَنْ صَلَّى عَلَى النَّبِيِّ وَآلِهِ مَرَّةً وَاحِدَةً بِنِيَّةٍ وَإِخْلَاصٍ مِنْ قَلْبِهِ فَضَيَّ اللَّهُ لَهُ
مِائَةً حَاجَةً؛ مِنْهَا ثَلَاثُونَ لِلدُّنْيَا وَسَبْعُونَ لِلْآخِرَةِ.

Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë:
*"Atij që dërgon një salavat me nijet të pastër dhe të çiltër
për profetin Muhamed dhe familjen e tij, Zoti i
Madhëruar i pranon 100 nevoja: 30 nga nevojat e botës
dhe 70 nga nevojat e Abiretit."*

Hadithi 10

Salavati i Zotit mbi dërguesin e salavatit

عَنْ الصَّادِقِ عَلَيْهِ السَّلَامُ عَنْ النَّبِيِّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ:

مَنْ صَلَّى عَلَيَّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَمَلَائِكَتُهُ ، وَمَنْ شَاءَ فَلْيُقَلِّ وَمَنْ شَاءَ فَلْيُكْثِرْ

.

Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) transmeton se Profeti Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!*) ka thënë: "*Allahu i Madhëruar dhe melekët dërgojnë salavat dhe mëshirë për këdo që dërgon salavat për mua.*"

Hadithi 11

Salavati është largues i shejtanit

قَالَ النَّبِيُّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ:

إِنَّ الشَّيْطَانَ اثْنَانِ: شَيْطَانُ الْجِنِّ وَ يُبْعَدُ بِ" لَا حَوْلَ وَلَا قُوَّةَ " إِلَّا بِاللَّهِ الْعَلِيِّ الْعَظِيمِ"، وَشَيْطَانُ الْإِنْسِ وَيُبْعَدُ بِالصَّلَاةِ عَلَى النَّبِيِّ وَآلِهِ.

Profeti Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!) ka thënë: "Shejtanët janë në dy grupe: Një grup janë shejtanët xhinde, të cilët dëbohen duke thënë: 'La haule ue la kuute il-la bil-lahi el-alijul adbijm' dhe grupi tjetër janë shejtanët njerëz, të cilët largohen prej njeriut me dërgimin e salavatit."

Hadithi 12

Humbja dhe padija në lënien e salavatit

عن الصادق عليه السلام:

إِذَا ذُكِرَ النَّبِيُّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ فَأَكْثِرُوا الصَّلَاةَ عَلَيْهِ، فَإِنَّهُ مَنْ صَلَّى عَلَى النَّبِيِّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ صَلَاةً وَاحِدَةً صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ أَلْفَ صَلَاةٍ فِي أَلْفِ صَفٍّ مِنَ الْمَلَائِكَةِ، وَمَنْ يَبْقَ شَيْءٌ مِمَّا خَلَقَهُ اللَّهُ إِلَّا صَلَّى عَلَى الْعَبْدِ لِصَلَاةٍ اللَّهُ عَلَيْهِ وَصَلَاةٍ مَلَائِكَتِهِ، فَمَنْ لَمْ يَرْعَبْ فِي هَذَا فَهُوَ جَاهِلٌ مُغْرُورٌ، قَدْ بَرَأَ اللَّهُ مِنْهُ وَرَسُولُهُ وَأَهْلُ بَيْتِهِ.

Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë:
"Kur të përmendet emri i Profetit Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!), dërgoni shumë salavat për të! Kushdo që dërgon një herë salavat për Profetin, Allahu i Madhëruar bashkë me një

mijë grupe melekësh dërgojnë nga një mijë salavate për të. Për shkak të salavatit të Allahut dhe të melekëve, asnjë krijesë prej krijesave të Allahut nuk mbetet pa dërguar për atë person salavat. Atëherë, nëse dikush nuk e shijon kënaqësinë e dërgimit të salavatit, ai është i paditur (dhe është i mashtruar nga shejtani). Allahu dhe i Dërguari i Tij e urrejnë një person të tillë."

Hadithi 13

**Tubimet (mexhliiset) pa salavate janë tubime për të cilat
do të pendoheni**

قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ:

مَا مِنْ قَوْمٍ اجْتَمَعُوا فِي مَجْلِسٍ فَلَمْ يَذْكُرُوا اسْمَ اللَّهِ عَزَّوَجَلَّ وَلَمْ يُصَلُّوا عَلَى
نَبِيِّهِمْ إِلَّا كَانَ ذَلِكَ الْمَجْلِسُ حَسْرَةً وَوَبَالًا عَلَيْهِمْ.

Profeti Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!*) ka thënë: "*Kur mblidhet një tubim dhe në të nuk kujtohet Zoti e nuk dërgohet salavat mbi Profetin dhe familjen e tij, ky tubim është për të ardhur keq (Në Ditën e Kiametit do të pendoheni për të).*"

Hadithi 14

Vepra më e mirë në ditën e xhuma

عَنْ مُولَانَا الصَّادِقِ عَلَيْهِ السَّلَامُ:

مَا مِنْ عَمَلٍ أَفْضَلَ يَوْمَ الْجُمُعَةِ مِنَ الصَّلَاةِ عَلَى مُحَمَّدٍ وَآلِهِ.

Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë:
"Asnjë vepër nuk ka më shumë vlerë në ditën e xhuma,
sesa dërgimi i salavatit për Muhamedin dhe familjen e
Muhamedit."

Hadithi 15

Takimi me imam Mehdiun (imamin e kohës)

عَنِ الصَّادِقِ عَلَيْهِ السَّلَامُ:

مَنْ قَالَ بَعْدَ صَلَاةِ الظُّهْرِ وَ صَلَاةِ الْفَجْرِ فِي الْجُمُعَةِ وَ غَيْرِهَا "اَللّٰهُمَّ صَلِّ عَلَى مُحَمَّدٍ وَآلِ مُحَمَّدٍ وَعَجِّلْ فَرَجَهُمْ " لَمْ يَمُتْ حَتَّى يُدْرِكَ الْقَائِمُ الْمَهْدِيُّ عَلَيْهِ السَّلَامُ.

Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: "*Kushdo që pas namazit të sabahut dhe të drekës thotë: 'Allahumme sal-li ala Muhamed ue ali Muhamed ue axhil ferexhehum', nuk do të vdesë pa e takuar imam Mehdiun (Allahu e shpejtoftë ardhjen e tij!).*

Hadithi 16

Salavati, shkak i faljes së gjynaheve

قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ:

مَنْ صَلَّى عَلَى كُلِّ يَوْمٍ ثَلَاثَ مَرَّاتٍ وَفِي كُلِّ لَيْلٍ ثَلَاثَ مَرَّاتٍ حُبًّا لِي
وَشَوْقًا إِلَيَّ كَانَ حَقًّا عَلَى اللَّهِ عَزَّوَجَلَّ أَنْ يَغْفِرَ لَهُ ذُنُوبَهُ تِلْكَ الَّتِي لَهُ
وَذَلِكَ الْيَوْمَ.

Profeti Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut gofshin mbi të dhe familjen e tij!*) ka thënë: "*Kushdo që nga dashuria dërgon salavat mbi mua tri herë gjatë ditës dhe tri herë gjatë natës, Zoti i Madhbërnar ia fal gjynahet e asaj dite dhe asaj nate.*"

Hadithi 17

Salavati, portë e shëndetit

قَالَ النَّبِيُّ الْأَعْظَمُ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ:

مَنْ صَلَّى عَلَىَّ مَرَّةً فَتَحَ اللَّهُ عَلَيْهِ بَاباً مِنَ الْعَافِيَةِ.

Profeti Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!*) ka thënë: " Kushdo që dërgon një herë salavat mbi mua, Zoti i Madhbëruar hap një portë shëndeti drejt tij."

Hadithi 18

Dërgimi i salavatit kur i marrim erë luleve

عَنْ مَالِكٍ [بْنِ أَعْيُنٍ] الْجُهَنِيِّ، نَاوَلْتُ أَبَا عَبْدِ اللَّهِ شَيْئاً مِنَ الرِّيَاحِينَ فَأَخَذَهُ
وَشَمَّهُ وَوَضَعَهُ عَلَى عَيْنَيْهِ، ثُمَّ قَالَ: مَنْ تَنَاوَلَ رِيحَانَ هَ فَشَمَّهَا وَوَضَعَهَا عَلَى
عَيْنَيْهِ ثُمَّ قَالَ: "اللَّهُمَّ صَلِّ عَلَى مُحَمَّدٍ وَآلِ مُحَمَّدٍ" لَمْ تَقَعْ عَلَى الْأَرْضِ حَتَّى
يُغْفَرَ لَهُ.

Nga Malik (bin A'jun) Xhuheni thuhet: "I
dhurova një borzilok imam Sadikut (Paqja qoftë mbi
të!). Ai e mori atë, i mori erë, e vuri mbi sy e pastaj tha:
‘Kushdo që merr një lule, i merr erë asaj, e vendos mbi
sy e pastaj thotë: 'Allahumme sal-li ala Muhamed ue ali
Muhamed', që nga momenti që e vendos lulen në tokë,
gjynahet e tij falen."

Hadithi 19

Përfundimi i fjalimit me salavat

قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ:

مَنْ كَانَ آخِرُ كَلَامِهِ الصَّلَاةَ عَلَيَّ وَعَلَى آلِي دَخَلَ الْجَنَّةَ.

Profeti Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!*) ka thënë: "*Kushdo që në fund të një fjalimi dërgon salavat mbi mua dhe mbi familjen e tij, do të hyjë në Xhenet.*"

Hadithi 20

Lutja më e mirë në Shtëpinë e Zotit (Qaben)

قَالَ عَبْدُ السَّلَامِ بْنُ نُعَيْمٍ لِمَوْلَانَا الصَّادِقِ عَلَيْهِ السَّلَامُ:

إِنِّي دَخَلْتُ الْبَيْتَ وَمَنْ يَحْضُرُنِي شَيْءٌ مِنَ الدُّعَاءِ إِلَّا الصَّلَاةَ عَلَى مُحَمَّدٍ وَآلِ مُحَمَّدٍ، فَقَالَ: أَمَا إِنَّهُ لَمْ يَخْرُجْ أَحَدٌ بِأَفْضَلٍ مِمَّا خَرَجْتَ بِهِ.

Abdu Selam bin Naim i ka thënë imam Sadikut (Paqja qoftë mbi të!): “*Hyra në Qabe dhe nuk më erdhi ndërmend asnjë lutje, përveç salavatit për Muhamedin dhe për familjen e tij.*’ Imami (Paqja qoftë mbi të!) tha: ‘*Dije se askush nuk ka bërë vepër më të mirë se ti.*’”

Hadithi 21

Pranimi i lutjes nga mirësia e salavatit

قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ:

كُلُّ دُعَاءٍ (يُدْعَى اللَّهُ عَزَّوَجَلَّ بِهِ) مَحْجُوبٌ عَنِ السَّمَاءِ حَتَّى يُصَلَّى عَلَى
مُحَمَّدٍ وَآلِ مُحَمَّدٍ.

Profeti Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!*) ka thënë: " Çdo lutje që i bëhet Zotit të Madhëruar, nuk ngjitet lart derisa të shoqërohet me salavat mbi Muhamedin dhe mbi familjen e tij."

Hadithi 22

Salavati në natën dhe ditën e xhuma

عن مُولانا الصَّادِقِ عَلَيْهِ السَّلام:

إِذَا كَانَتْ عَشِيَّةُ الْحَمِيسِ وَلَيْلَةُ الْجُمُعَةِ نَزَلَتْ مَلَائِكَةٌ مِنَ السَّمَاءِ مَعَهَا أَقْلَامُ
الذَّهَبِ وَصُحُفُ الْفِضَّةِ، لَا يَكْتُبُونَ (عَشِيَّةَ الْحَمِيسِ وَ لَيْلَةَ الْجُمُعَةِ إِلَى أَنْ
تَغِيبَ الشَّمْسُ) إِلَّا الصَّلَاةَ عَلَى النَّبِيِّ وَآلِهِ.

Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë:
"Mbrëmjen e së enjtes dhe ditën e xhuma, melekët
xhresin në tokë me lapsa prej floriri dhe fleta prej
argjendi. Deri në perendimin e ditës së xhuma, ata nuk
shkruajnë gjë tjetër vetëm se sevapin e dërgimit të
salavatit mbi Muhamedin dhe familjen e tij."

Hadithi 23

Salavati është zbulurimi i lutjes

عن الصادق عليه السلام عن النبي صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ:

إِجْعَلُونِي فِي أَوَّلِ الدُّعَاءِ وَ فِي آخِرِهِ وَ فِي وَسْطِهِ.

Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) transmeton nga Profeti Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!) se ka thënë: " *Më kujtoni mua me salavat në fillim, në mes dhe në fund të lutjes suaj.*"

Hadithi 24

Përgëzimi i Xhibrailit (Paqja qoftë mbi të!) për të Dërguarin e Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!)

قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ بَعْدَ أَنْ سَجَدَ سَجْدَةً طَوِيلَةً:

لَقِينِي جِبْرِيلَ فَبَشِّرْنِي، قَالَ: إِنَّ اللَّهَ عَزَّوَجَلَّ يَقُولُ: مَنْ صَلَّى عَلَيْكَ صَلَّيْتُ عَلَيْهِ وَمَنْ سَلَّمَ عَلَيْكَ سَلَّمْتُ عَلَيْهِ، فَسَجَدْتُ لِذَلِكَ.

I Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!), pas një sexhdeje të gjatë, tha: "*Më takoi Xhibraili (Paqja qoftë mbi të!) dhe më tha: Allahu i Madhbëruar ka thënë: 'Kushdo që dërgon salavat mbi ty, Unë dërgoj për të salavat dhe kushdo që të dërgon selam ty, Unë i dërgoj atij selam.'* Kur e mora këtë lajm, rashë në sexhde."

Hadithi 25

Tre dobi të salavatit

عَنِ النَّبِيِّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ:

صَلَاتُكُمْ عَلَى مُحَمَّدٍ ؑ لِدُعَائِكُمْ، وَمَرْضَاةٌ لِرَبِّكُمْ، وَزَكَاةٌ لأَعْمَالِكُمْ
(لأبدانِكُمْ)

I Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!) ka thënë: "*Salavati është shkak i pranimit të lutjes suaj; është shkak i kënaqësisë së Allahut; është shkak i pastrimit të gjynahëve tuaja.*"

Hadithi 26

**Ndriçimi i varrit, i Siratit dhe i Xhenetit nga mirësia
e salavatit**

قَالَ النَّبِيُّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ:

أَكْثَرُوا الصَّلَاةَ عَلَيَّ فَإِنَّ الصَّلَاةَ عَلَيَّ نُورٌ فِي الْقَبْرِ، وَنُورٌ عَلَيَّ الصِّرَاطِ، وَنُورٌ
فِي الْجَنَّةِ.

I Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!) ka thënë: "*Dërgoni sa më shumë salavate mbi mua, sepse dërgimi i salavatit mbi mua është dritë në varr, është dritë në Urën e Siratit dhe është dritë në Xhenet.*"

Hadithi 27

Vepra më e mirë në ditën e Xhuma

سَأَلَ حَمَّادُ بْنُ عِيسَى عَنْ أَبِي عَبْدِ اللَّهِ عَنْ أَفْضَلِ الْأَعْمَالِ يَوْمَ الْجُمُعَةِ، قَالَ
عَلَيْهِ السَّلَامُ:

الصَّلَاةُ عَلَى مُحَمَّدٍ وَآلِ مُحَمَّدٍ مِائَةَ مَرَّةٍ بَعْدَ الْعَصْرِ وَمَا زِدْتَ فَهُوَ أَفْضَلُ.

Hamad bin Isa e pyeti imam Sadikun (Paqja qoftë mbi të!) se cila ishte vepra më e mirë në ditën e Xhuma. Ai (Paqja qoftë mbi të!) iu përgjigj: *"Dërgimi i 100 salavateve për Muhamedin dhe familjen e Tij në pasditen e saj (ditës së xhuma). Sa më shumë salavat të dërgosh, aq më shumë mirësi e begati ka."*

Hadithi 28

Melekët, mbajtësit e Arshit

بَعْدَ أَنْ لَمْ تَقْدِرِ الْمَلَائِكَةُ لِحَمْلِ الْعَرْشِ، قَالَ اللَّهُ تَعَالَى لَهُمْ:

أَعْلَىٰ مُكُمْ كَلِمَاتٍ تَقُولُونَهَا يَخَفُ بِهَا عَلَيْكُمْ، قَالُوا: وَمَا هِيَ يَا رَبَّنَا؟ قَالَ:

تَقُولُونَ: "بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ وَلَا حَوْلَ وَلَا قُوَّةَ إِلَّا بِاللَّهِ الْعَلِيِّ الْعَظِيمِ

وَصَلَّى اللَّهُ عَلَى مُحَمَّدٍ وَآلِهِ الطَّيِّبِينَ" فَقَالُوا فَحَمَلُوهُ

Kur melekët ishin të paaftë në mbajtjen e Arshit, Allahu i Madhëruar u tha: *"Do ju mësoj një lutje dhe dhikër, që me bereqetin dhe mirësinë e saj, do të mund ta mbani Arshin. Melekët thanë: Na e thuaj atë. Allahu*

tha: Thuani: Bismil-lahirr Rrahmanirr Rrahijm ue la haule ue ka kuuete il-la bil-lahi el alijul adhim ue sal-lallahu ala Muhamedin ue alihit tabirijn. (Me emrin e Allahut të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit. O Allah! Dërgo paqe mbi Muhamedin dhe familjen e tij të pastër!).” Atëherë arritën ta mbanin Arshin.

Hadithi 29

Selami i 70 mijë melekëve për dërguesin e salavatit

قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ:

جَائِئِي جِبْرِيلُ وَقَالَ: إِنَّهُ لَا يُصَلِّي عَلَيْكَ أَحَدٌ إِلَّا وَصَلَّى عَلَيْهِ سَبْعُونَ أَلْفَ
مَلَكٍ وَمَنْ صَلَّى عَلَيْهِ سَبْعُونَ أَلْفَ مَلَكٍ، كَانَ مِنْ أَهْلِ الْجَنَّةِ.

I Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!) ka thënë: *"Xhibraili erdhi tek unë dhe më tha: Nuk ka njeri që të dërgojë salavat mbi ty dhe të mos dërgojnë për të salavat 70 mijë melekë. Për këdo që dërgohen 70 mijë salavate, Xheneti është i sigurtë."*

Hadithi 30

Njeriu më i afërt me Profetin në Ditën e Ringjalljes

قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ:

أَوْلَى النَّاسِ بِي يَوْمَ الْقِيَامَةِ أَكْثَرُهُمْ عَلَيَّ صَلَاةً (فِي دَارِ الدُّنْيَا)

Profeti Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!) ka thënë: "*Në Ditën e Kiametit, më i afërti prej jush me mua do të jetë ai, i cili më ka dërguar më shumë salavate.*"

Hadithi 31

**Sevapi (shpërblimi) i salavatit nuk mund të llogaritet
(numërohet)**

فِي لَيْلَةِ الْمِعْرَاجِ بَعْدَ أَنْ رَأَى النَّبِيُّ مَلَكًا يُحَاسِبُ عَدَدَ قَطَرَاتِ الْمَطَرِ، قَالَ
الْمَلَكُ لَهُ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ:

يَا رَسُولَ اللَّهِ، حَسَابٌ لَا أَقْدِرُ عَلَيْهِ بِمَا عِنْدِي مِنَ الْحِفْظِ وَالتَّدْكِيرِ وَالْأَيْدِي
وَالْأَصَابِعِ، فَقَالَ: أَيُّ حِسَابٍ هُوَ؟

فَقَالَ: قَوْمٌ مِنْ أُمَّتِكَ يَحْضُرُونَ جَمْعًا فَيَذْكُرُ اسْمَكَ عِنْدَهُمْ فَيُصَلُّونَ عَلَيْكَ،
فَأَنَا لَا أَقْدِرُ عَلَى حَصْرِ نَوَائِمِهِمْ.

Në natën e Miraxhit, Profeti (Paqja dhe bekimet
e Allahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!) pa
një melek, i cili numëronte pikat e shiut që binin.

Meleku tha: *“O i Dërguar i Allahut! Është një llogari të cilën unë nuk arrij ta bëj me gjithë fuqinë që më është dhënë.”* Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!) i tha: *“Cila është ajo?”* Meleku tha: *“Sa herë që në një vend tubohet një grup njerëzish dhe në këtë tubim pasi dëgjohet emri yt, dërgohet salavat mbi ty, unë nuk jam në gjendje t’i numëroj sevapet e salavatit.”*

Hadithi 32

Mënjanimi i varfërisë me anë të salavatit

قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ:

الصَّلَاةُ يَدْفَعُ الْفَقْرَ

Profeti Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!) ka thënë:
"Dërgimi i salavatit mënjanon varfërinë."

Hadithi 33

Mirësia e salavatit në muajin e Ramazanit

قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ:

مَنْ أَكْثَرَ فِيهِ مِنَ الصَّلَاةِ عَلَى ثَقُلَ اللَّهُ مِيزَانَهُ يَوْمَ تَخْفُ الْمَوَازِينُ.

Profeti Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!) ka thënë:
"Kushdo që dërgon shumë salavate për mua në muajin e Ramazanit, Allahu i Madhbëruar mirësitë e tij ia rëndon në peshë, në atë ditë kur mirësitë e të tjerëve janë të lehta (peshojnë lehtë)."

Hadithi 34

Vepra më e rëndë në peshoren e veprave është salavati

عن الصادق عليه السلام : ما في الميزان شيء أثقل من الصلاة على محمد
وآل محمد.

Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: "*Në peshoren e veprave nuk ka vepër që peshon më rëndë se salavati për Muhamedin dhe për familjen e Muhamedit.*"

Hadithi 35

Shlyerja e gjynaheve me salavat

عن الامام الرضا عليه السلام:

من لم يقدر على ما يكفّر به ذنوبه فليكثر من الصلاة على محمّد وآله، فإنّها
تهدم الذنوب هدماً.

Imam Rizai (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: "*Ai që nuk mund t'i shlyejë gjynabet e tij me anë të pagesës, le të dërgojë sa më shumë salavate mbi Muhamedin dhe mbi familjen e Muhamedit. Me të vërtetë, salavati i zhduk gjynabet.*"

Hadithi 36

**Sevapi (shpërblimi) i salavatit si shpërblimi i rukusë,
i sexhdes dhe i kijamit**

قال أبو عبد الله عليه السلام:

من قال في ركوعه وسجوده وقيامه: «اللهم صلّ على محمد وآل محمد»
كتب الله له بمثل الركوع والسجود والقيام. (38)

Imam Bakiri (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë:
*"Kushdo që dërgon salavat kur ndodhet në rukun, sexhde
dhe kijam (qëndrim) duke thënë 'Allahumme sal-li ala
Muhamed ue ali Muhamed', Allahu ia shkruan si
sevapin e rukusë, të sexhdes dhe të kijamit."*

Hadithi 37

Harrimi i salavatit, shkak i humbjes së rrugës së Xhenetit

قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ:

مَنْ نَسِيَ الصَّلَاةَ عَلَيَّ اِحْطَأَ طَرِيقَ الْجَنَّةِ

Profeti Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!) ka thënë: *"Ai që harron të dërgojë salavat për mua, ka humbur rrugën e Xhenetit."*

Hadithi 38

Shpëtimi nga djegia e zjarrit të Xhehenemit

قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ:

لَنْ يُلْجَ النَّارَ مَنْ صَلَّى عَلَى...

Profeti Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!) ka thënë:
"Nuk e djeg Zjarri atë që dërgon salavat për mua."

Hadithi 39

Pranimi i lutjes

قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ:

مَنْ قَالَ ثَلَاثَ مَرَّاتٍ: "اَللّٰهُمَّ صَلِّ عَلٰى مُحَمَّدٍ وَ اٰلِ مُحَمَّدٍ" قَضٰى اللّٰهُ حَاجَتَهٗ

Profeti Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!) ka thënë:
"Kush thotë tri herë 'Allahumme sal-li ala Muhamed ue ali Muhamed', i pranohen tri lutje."

Hadithi 40

Salavati mes namazit të drekës dhe të ikindisë

عن الصادق عليه السلام:

الصَّلَاةُ عَلَى مُحَمَّدٍ وَآلِ مُحَمَّدٍ فِيمَا بَيْنَ الظُّهْرِ وَالْعَصْرِ تَعْدِلُ سَبْعِينَ رَكْعَةً
(حَجَّةً)

Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë:
"Dërgimi i salavatit në mes të namazit të drekës dhe të ikindisë është i barabartë me 70 rekate namaz mustehab (ose 70 haxhe)."

چهل حدیث

درباره فضیلت صلوات

تیرانا: 2015

اسم کتاب: چهل حدیث درباره فضیلت صلوات

مترجم: صبریه فزا

مقابلہ: ولنت مریا

جلد و صفحہ آرایہ: صبریه فزا

ویرایش: لیسدا رامای

ناشر: موسسہ قرآن آلبانی

تیرانا: 2015